



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

(Adresa, Sheshi "Abdyl Frasheri", Email: keshillibashkiakpermet@gmail.com)

Komisioni i Përhershëm i Buxhet Financës dhe Ligjeve

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 1 datë 28/03/2025

Nr. ____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit "Për miratimin e Tavanëve të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028" datë 28/03/2025, relacionit dhe dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin.

Analiza ligjore:

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për manaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", Udhëzimit nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit Buxhetor Afatmesëm të njëjësive të vetqeverisjes vendore, Udhëzimit nr.7 datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028", VKB nr.11 datë 30.01.2025 'Për miratimin e të ardhurave afatmesme për Buxhetin afatmesëm 2026-2028'.

Situata aktuale e funksionit:

Të ardhurat nga burimet qendrore, rezultojnë të jenë element dominues dhe përcaktues në strukturën dhe performancën e të ardhurave totale. Varësia financiare nga transfertat ndërqeveritare bën që planifikimi i investimeve kapitale të jetë subjekt i kushtëzuar pothuajse tërësisht nga vendimet e qeverisë qendrore. Pavarësia financiare e Bashkisë Përmet, matur si raport i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave totale, rezulton mesatarisht 23 % për trevjeçarin 2026 - 2028. Niveli i të ardhurave vendore përcaktohet në masën më të madhe nga performanca e taksave dhe tarifave vendore.

Situata financiare :

Të ardhurat e veta vendore per vitet 2026 - 2028, zënë mesatarisht 23 % të totalit të buxhetit. - 2025: 74865 mijë lekë - 2026: 92705 mijë lekë (+23%) - Mesatarja 2026-2028: 98236 mijë lekë (+31% krahasuar me 2025)

- Transferta e pakushtëzuar per vitet 2026 - 2028 zë mesatarisht 48 % të totalit të buxhetit. - 2025: 197639 mijë lekë - 2026: 203455 mijë lekë (+2.9%) - Mesatarja 2026-2028: 209585 mijë lekë (+6 % krahasuar me 2025)

- Transferta e pakushtëzuar sektoriale per vitet 2026 - 2028 zë mesatarisht 26 % të totalit të buxhetit. - 2025: 130992 mijë lekë - 2026: 114002 mijë lekë (+13%) - Mesatarja 2026-2028: 114002 mijë lekë (+13% krahasuar me 2025)

- Totali i shpenzimeve te personelit per vitin 2026 është 280939 mijë lekë dhe zë 65 % të totalit të buxhetit , per vitin 2027 është planifikuar 283633 mijë lekë dhe ze 64 % te totalit te buxhetit dhe per vitin 2028 është planifikuar 283633 mijë lekë dhe ze 66 % të totalit të buxhetit.

- Totali i shpenzimeve operative per vitin 2026 është 83073 mijë lekë, per vitin 2027 është planifikuar 93213 mijë lekë dhe per vitin 2028 është planifikuar 93213 mijë lekë dhe zënë mesatarisht 21% të totalit të buxhetit.

- Totali i investimeve ku perfshihen per vitin 2026 është 58739 mijë lekë, per vitin 2027 është planifikuar 59761 mijë lekë dhe per vitin 2028 është planifikuar 54205 mijë lekë dhe zënë mesatarisht 13 % të totalit të shpenzimeve.

Burime të tjera të ardhurash të përfshira në PBA 2026-2028 janë dhe projektet me financim të huaj me skemë të plotë thesari.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Koordinatori i GMS ka raportur lidhur me Tavanet Buxhetore 2026-2028

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe të gjithë këshilltarët do të ndjekin ecurinë e procesit të hartimit të PBA 2026-2028

Impakti social / grupet që preken: Programi Buxhetor Afatmesem 2026-2028 dhe Buxheti Vjetor per vitin 2026 impakton jetën të gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e të gjithë territorit të Bashkisë Përmet.

Komisioni i Përhershëm për “Komisioni i Përhershëm i Buxhet Financës dhe Ligjeve”, i mbledhur me datën 28.03.2025, shqyrtoi projekt dhe dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin “Për miratimin e Tavanëve të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028” të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.


Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,


VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit




Agathokli PROKO
(emri, mbiemri, firma)




Kryetar i Komisionit

Adelina SKRAPALLIU
(emri, mbiemri, firma)




Sekretar i Komisionit

Agim ANDONI
(emri, mbiemri, firma)



Nënkryetar i Komisionit

Ganimeta TAFANI
(emri, mbiemri, firma)



Anëtar i Komisionit

Armando TATAZI
(emri, mbiemri, firma)

Anëtar i Komisionit